



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:181290

Datë: 26.06.2024

Numri i dokumentit: 05862654

KPPP.nr. 1965/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbartimore të kreditorit “ÇETA – General Invest Group” SH.P.K., me numër unik identifikues 810298621 me seli në Fushë Kosovë, rr. “Nëna Terezë”, nr.158, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shkodran Manaj avokat në Fushë Kosovë, rr. “Mumin Gashi”, kundër debitorit Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas prapësimit të debitorit ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor, P.nr.312/22, i lejuar me datë 04.07.2022, nga Përmbartuesi Privat, Destan Bujupaj në Prishtinë, me datë 26.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.312/22, të datës 04.07.2022, të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.312/22, i lejuar më datë 04.07.2022, të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, Destan Bujupaj duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit “ÇETA – General Invest Group” SH.P.K., mbi bazën e dokumentit të besueshëm, Faturës numër 50/2021 e datës 24.12.2021 me të cilin ka detyruar debitorin që në emër të borxhit t’ia paguaj kreditorit shumën prej 36,446.25€ (tridhjetë e gjashtë mijë e katërqind e dyzet e gjashtë euro e njëzet e pesë cent), si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm. Në të kundërtën përmbartimi të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare,

sekuestrimin, e sendeve të luajshme dhe të paluajshme të debitorit, dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasomi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori, ndaj urdhrin mbi lejimin e përmbarimit ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar urdhrin përmbarimor, për pagesën e faturës së lëshuar nga kreditori “ÇETA – General Invest Group” SH.P.K., me arsyetimin se propozimi për përmbarim ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarimore si dhe konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Debitori në bazë të kontratës nr.242-21-4519-5-1-1/C248, Lot 4: Renovimi i Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit të Edukimit, ka pasur për obligim të përmbush detyrat sipas punëve dhe nevojave të njëjësive akademike për Renovimin e Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit të Edukimit. Më tutje debitori sqaron se pas lidhjes së kontratës mes AK dhe OE me nr.242-21-4519-5-1-1/C248, në zbatim të mbikëqyrjes së punimeve, si menaxher i kontratës në fjalë ishte emëruar G.Z. ndërsa si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës ishte emëruar A.H.. Më tutje sqaron se Operatori Ekonomik kishte pretenduar se punimet janë kryer sipas kontratës gjë që nuk ishte e saktë dhe nuk ishte pranuar nga menaxheri i kontratës, pasi që kompania pa miratimin e askujt kishte ndryshuar disa nga pikat e kontratës, me pretendimin se do të shtonte disa pika të tjera dhe do ti dërgonte një vlerë më të vogël se sa kontrata të cilën e kishin lidhur, e të cilën nuk e kishte dërguar asnjëherë. Më tutje thekson se Menaxheri i Kontratës, G.Z. kishte kërkuar nga kompania që të korrigohej të gjitha pozicionet të cilat ka shprehur pakënaqësi mirëpo Operatori Ekonomik nuk i kishte ndryshuar e as nuk kishte dërguar raport për to, kështu në shenjë pakënaqësie më datën 29.12.2021 menaxheri i kontratës G.Z. jep dorëheqje. Ka shtuar se me anë të një komunikimi elektronik, menaxheri i kontratës G.Z. pretendon se emri i tij ishte shënuar në dy vende, gjë të cilën ai nuk e praktikon në këtë mënyrë, pasi këtë e bën duke vendosur nënshkrimin dhe jo duke shënuar emrin, duke pretenduar kështu që mund të ketë falsifikim me emrin e tij duke e shfrytëzuar padijeninë e tij në procese të tilla. Më tutje shton se Operatori Ekonomik kishte dërguar faturën në zyre të prokurimit me nr.50/21 të datës 24.12.2021, duke njoftuar se i kanë plotësuar dhe ndryshuar pozicionet që ka kërkuar menaxheri i kontratës, pikërisht ditën e dorëzimit të Raportit të Situacionit të parë dhe përfundimtar të mbikëqyrur nga Organi Mbikëqyrës i kompanisë “P.M.N” SH.P.K., që mban nr.prot: 3/177 i datës 24.12.2021, duke e vendosur në lajthitje edhe udhëheqësin e zyrës së prokurimit z. S.Q., që të njëjtën ditë pas pranimit të raportit e pranon faturën me nr 50/2021 sipas Planit për Menaxhimin e Kontratës me Nr.Prot 3/180 i datës 24.12.2021, plan të cilin nuk e ka pranuar menaxheri i kontratës G.Z. , dhe as mbikëqyrësi i tij A.H.. Andaj, gjykatës i ka propozuar që të aprovoj prapësimin e debitorit në tërësi si të bazuar dhe të anulohet në tërësi urdhrin

përmbartimor të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj, me numër , P.nr.312/22, të datës 04.07.2022.

Kreditori në përgjigje në prapësim i kundërshton në tërësi thëniet e debitorit si të pabazuara, duke shtuar se nga prapësimi i debitorit vërehet qartë se qëllimi i tij është vetëm shtyrja dhe prolongimi i pagesës së borxhit që ka ndaj kreditorit. Kreditori deklaron se është në origjinal e pranuar dhe nënshkruar fatura nga debitori si pranues i shërbimit sipas kontratës nr.242-21-4519-5-1-1 me numër protokolli Nr.Prot 3/885 e datës 25.11.2021 për renovimin e Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit të Edukimit, dhe se fatura është deklaruar në ATK, si faturë e rregullt. Andaj, pretendimet e paraqitura në prapësim lidhur me mos përmbushjen e kontratës nuk qëndrojnë pasi që kontrata është përmbushur në tërësi dhe debitori nuk ka sjellë asnjë dëshmi me të cilën e vërteton se menaxheri G.Z. ka kërkuar nga kreditori të ndryshohen të gjitha pozicionet, për më tepër Organi Mbikëqyrës i kompanisë “P.M.N” SH.P.K., ka pranuar punët e kryera ndërtimore duke specifikuar dhe vlerën e punëve të kryera dhe duke i dërguar Raportin e Situacionit të parë dhe përfundimtar të cilin raport debitori e ka pranuar dhe nuk e ka kundërshtuar. Më tutje thekson se lidhur me pretendimet e debitorit se menaxheri i kontratës kishte dhënë dorëheqje për shkak të pakënaqësive lidhur me mos realizimin e kontratës, nuk qëndrojnë pasi që punimet janë kryer më datë 24.10.2021 ndërsa menaxheri ka dhënë dorëheqje më datë 29.12.2021 i cili në arsyetimin e tij ka cekur se për këtë pozitë duhet të vendoset dikush tjetër i cili është më kompetent dhe ka njohuri në fushën e Inxhinierisë, më tutje në arsyetimin e tij ka thënë se kjo pozitë në fillim i është propozuar duke deklaruar se përgjegjësia e tij e vetme është që të përcjell nëse punëtorët e kompanisë janë paraqitur në punë për ti përfunduar punët e tyre. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të refuzoj në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar, dhe të lë në fuqi urdhrin përmbartimor, P.nr.312/22, i lejuar me datë 04.07.2022 nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – përkatësisht – Faturës numër 50/2021 e datës 24.12.2021 e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, është i përshkruar objekti i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga vula e protokollimit të debitorit.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, mban nënshkrimin e pranimit të përfaqësuesit të debitorit si dhe raportin e organit mbikqyrës se punimet janë realizuar në vlerën 36,446.25€.

Gjykata vlerësoi pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi.

Gjykata vlerësoi edhe komunikimet elektronike të dorëzuara si prova me prapësim por gjeti se të njëjtat janë komunikime në mes të përfaqësuesve të debitorit dhe se për të njëjtat kundërshtime nuk është njoftuar kreditori andaj gjykata të njëjtat nuk i morri parasys.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1965/23, datë 26.06.2024

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.